



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

ICC INCOTERMS 2010 SI STANDARD MODERN INTEGRUES, APLIKIMI I DREJTË MUNDËSI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

BA. Jeton Vokshi, MSc (Cand.)

College 'Pjetër Budi' Prishtina

jeton.vokshi@intereuropa.si

Abstrakt:

Në zhvillimin ekonomik të çdo shteti, tregtia apo këmbimi ndërkombëtar i mallrave dhe shërbimeve ka një rol shumë të madh dhe të rëndësishëm. Transporti i mallit nga një shtet në tjetrin (nga shitësi deri te blerësi, eksportuesi deri te importuesi, dërguesi deri te pranuesi), veçanërisht në kohën moderne ku në shumë raste bëhet fjale për distanca të mëdha ku përdoren rrugë dhe mjete të ndryshme transportuese, malli vazhdimisht është i ekspozuar manipulimeve të ndryshme (ngarkim, shkarkim, magazinim, ripaketim, etiketim, shenjifikim etj.) duke shkaktuar shpenzime manipulative dhe transportuese, duke qenë i ekspozuar rreziqeve të shumta (nga dëmtimi, humbja, vjedhja, vonesa në liferim etj.) prandaj nëse të gjitha këto procese nuk janë të rregulluara, qartësuara në kontratën shitblerëse, kontestet përfundojnë në procese gjyqësore apo të arbitrazhit me kosto materiale dhe me humbje kohe.

Ekonomia globale i ka mundësuar biznesit një çasje aq të madhe, të paparë më herët respektivisht një çasje në tregje përgjatë gjithë globit. Sot mallrat shiten në më shumë shtete, në sasi më të mëdha, dhe me një llojllojshmëri më të madhe se kurdoherë më parë. Me rritjen e sasisë së mallrave në qarkullim dhe me rritjen e kompleksitetit në tregti ndërkombëtarë po ashtu rriten edhe gjasat për keqkuptim dhe konteste të kushtueshme në rastet kur kontratat e shitblerjes janë joadekuate, kanë lëshime apo thjeshtë nuk janë të plota në kuptim të parashikimit të situatave të ndryshme përgjatë proceseve të bartjes së mallit nga shitësi deri te blerësi¹.

Këto çështje i rregullon Oda Ekonomike Ndërkombëtare me seli në Paris, Francë e cila që nga viti 1936 i përpilon dhe publikon termet tregtare ndërkombëtare të njohura si INCOTERMS², ku të fundit janë INCOTERMS 2010.

Punimi është i ndarë në 3 pjesë: 1) Kuptimi i termeve tregtare INCOTERMS, 2) Përdorimi i INCOTERMS në Republikën e Kosovës nga pjesmarrësit aktiv në tregti ndërkombëtarë dhe 3) Rëndësia e përzgjedhjes së termit më të përshtatshëm – efekti në zhvillimin ekonomik dhe rritje të punësimit.

¹ International Chamber of Commerce, Incoterms 2010, 2010 f4.

² International Commercial Terms

Incoterms-at e përzgjedhur janë sqaruar në detale (sipas ICC-së) me paraqitje grafike. Analiza e pasqyrimin të përdorimit të Incoterms termeve në Kosovë merret nga praktika respektivisht nga shembujt e qindra rasteve të importeve dhe të eksporteve nga puna shumëvjeçare në lëmin e shpedicionit ndërkombëtar. Rezultatet e hulumtimit me shembuj nga praktika faktojnë se sa rëndësi ka përzgjedhja e Incoterms termit më të përshtatshëm ku me vetëm një ndryshim që mund të duket në shiqim të parë i parëndesishëm (ndryshimi apo përzgjedhja e Incoterms termit më të përshtatshëm) krijohen të hyra shtesë për biznesin, për ekonominë vendore duke ndikuar direkt në rritje ekonomike dhe duke reflektuar edhe me rritje të punësimit.

Fjalët kyçe: *ICC, INCOTERMS 2010, standardizimi, tregtia ndërkombëtare, zhvillimi ekonomik*